



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63.4, neni 15.5 nenit 25 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 6.3 dhe nenit 7.1 të Rregullës Zgjedhore nr.08/2013 Çertifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të Tyre dhe nenit 3 të Rregullës Zgjedhore 15/2013 Zgjedhjet e Parakohshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 10/09/2019 merr këtë:

### V E N D I M

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për çertifikimin e Partisë Politike "KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA" - KNRP, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, me tetë (8) kandidatë në Listë.
- II. Zyra obligohet që të njoftoj Partinë Politike "KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA" - KNRP, për marrjen e këtij Vendimi, pasi janë plotësuar kriteret e përcaktuara për çertifikim për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06 Tetor 2019.
- III. Subjekti politik i çertifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim në të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje, jo më vonë se një (1) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



**Këshillë juridike:** Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës – PZAP.